



**Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDREYSHE**

28 janar 2014, Prizren

**KOMUNIKATË PËR MEDIA
Transparenca përmirëson shërbimet dhe qeverisjen komunale**

Në kuadër të projektit të monitorimit të transparencës së ekzekutivit komunal të Prizrenit, EC Ma Ndryshe gjatë muajit janar ka shqyrtuar çështjen e hulumtimit të kontraktuar nga qeveria lokale për "Përmirësimin e shërbimeve komunale, përgjegjshmërisë dhe zhvillimit të ekonomisë lokale".

Sipas arsytimit të dhënë nga Komuna gjatë shpalljes dhe dhënies së këtij tenderi, ky hulumtim parashihet që të lehtësoj arkëtimin e të hyrave vetanake. Mirëpo ndonëse hulumtimi dhe raporti janë kryer në dhjetor të vitit të kaluar, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave ende nuk e ka bërë publike përmbajtjen e raportit. Nga buxheti komunal për këtë hulumtim janë shpenzuar afër 10 mijë euro.

Në komunikim me drejtuesit në detyrë të DEF-it është marrë sqarimi se raporti nga hulumtimi nuk është publikuar për shkak se pritet formimi i qeverisë së re komunale dhe se më pas do të publikohet në ueb faqen e komunës e nëse është nevoja do të ftohen edhe mediet.

Me dëshirën që DEF ta përmbush këtë zotim, duke qenë se ka përgjegjësi publike, EC Ma Ndryshe pret nga zyrtarët komunal t'i shpalosin të gjeturat e hulumtimit në afatin sa më të shkurtër kohor, me qëllim që të zhvillohet debati mbi përmirësimin e shërbimeve komunale, përgjegjshmërinë dhe zhvillimin e ekonomisë lokale, me përfshirjen e të gjithë akterëve relevantë.

Megjithëkëtë EC Ma Ndryshe përkujton se një hulumtim i ngjashëm ishte bërë edhe në nëntor të vitit 2012, me kosto prej afër 10 mijë eurosh, dhe DEF asnjëherë nuk i ka bërë publike të gjeturat e raportit, përkundër faktit se mjetet e buxhetit komunal ishin shpenzuar me qëllim të identifikimit të problemeve dhe gjetjes së mundësive të përmirësimit të të hyrave vetanake të komunës së Prizrenit.

Për këto arsye EC Ma Ndryshe rekomandon Komunën e Prizrenit që:

- Të zbatoj në përpikëri dispozitat e Udhëzimit Administrativ 2008/09 të MAPL-së për transparencë;
- Të raportoj më shpesh në media për çështjet që lidhen me shërbimet komunale, përdorimin e buxhetit komunal, zhvillimin ekonomik, përdorimin e pronës komunale, planifikimin urban, investimet, të hyrat komunale dhe çështje tjera;
- Të mbajë konferenca periodike të shtypit me mediet; dhe
- Të organizoj debate me shoqërinë civile, komunitetin e biznesit dhe hisedarët tjerë rreth sfidave të ndryshme që kanë të bëjnë me qeverisjen lokale.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit dhe të Mamushës publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren
Rr. Perandori Dioklician 14 Kati V (te Qafa) - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

Projekti "Transparenca online e komunave të Prizrenit dhe Mamushës" prej muajit maj 2013 përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.